



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT**

Nr. 16815 Prot

Shkodër, më 4.11.2019

Lënda: Kthim përgjigje.

**Z.**

**Rruga "Besnik Sykja", Nr 25, Shkodër**

**Për dëjani: KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR** ✓

**KRYETARIT TË QARKUT SHKODËR**  
**Rruga "13 Dhjetori", Shkodër**

*I nderuar,*

Në përgjigje të kërkesës Tuaj, administruar pranë Bashkisë Shkodër nr.16815 Prot., datë 04.10.2019, me lëndë: "Kërkesë për rikonstrukcion shtëpie", Ju bëjmë me dije se:

Bashkia Shkodër me vendim nr. 77, datë 11.04.2019, "Për marrjen e nismës për hartimin e PDV në njësinë SH007UB sipas PPV", ka filluar procesin e hartimit të PDV- së për njësinë strukturore ku përfshihet dhe prona Juaj.

Vendimi i sipërcituar në pikën 3 përcakton: "*Pezullimin e dhënies së lejeve të reja zhvillimore/ndërtimore gjatë periudhës së hartimit të PDV, deri në miratimin e saj, me përjashtim të: a. zhvillime për të cilat leja e ndërtimit është miratuar, përpara vendimit për pezullimin e zhvillimit; b. punimet e mirmbajtjes; c. zhvillime publike, shtetërore me interes vendor ose kombëtar*".

Sa më sipër, pas miratimit të PDV-së të njësisë SH007UB, Bashkia Shkodër do mund të marrë në shqyrtim dhe të miratojë sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit kërkesën Tuaj për rikonstrukcion objekti.

Duke ju falenderuar e uruar në mirëkuptimin Tuaj,



**KRYETAR**  
*[Signature]*  
**Voltana Ademi**